




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 09.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **07.10.2020**, të parashtruar nga OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra** ”, me nr të prokurimit **651-20-4015-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 020 043 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra** ”, me nr të prokurimit **651-20-4015-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 020 043 521** e dt. **07.10.2020** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **12.08.2020** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës 12.08.2020**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. ,me datë **07.10.2020** , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra** ”, me nr të prokurimit **651-20-4015-5-2-1**

dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 020 043 521. Autoriteti Kontraktues me datë **08.10.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të dt. 12.08.2020 ka shqyrtuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Sa l përket qasjes në dokumenta – OE ka kërkuar qasje në dokumenta sa l përket OE të shpallur fitues “ Company Zuka Commerce Sh.p.k. ”

AK ka ofruar qasje në Dokumente me datë 06.10.2020 e martë me fillim në ora 14 : 00. Zyrtarët e Prokurimit me fillim të qasjes së Dokumentave në prani të OE “ Bejta Commerce Sh.A. ” me përfaqësues z. Musë Pireva kanë hasur se tek OE “ Company Zuka Commerce Sh.p.k. ” tek Aneksi nr. 3 Kërkesa për Sekret Afarist figuron “ Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale “ Andaj, Ak ka kërkuar nga OE “ Company Zuka Commerce Sh.p.k. ” të lejohet qasja. Me konfirmim nga ana e OE ju është lejuar qasja OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a.

Gjithashtu, gjithcka ka qenë në përputhje me Ligjin e Prokurimit.

Ku, si përfundim në Procesverbalin e Mbajtur specifikohet që Ztr. Musë Pireva ka ardhur në përfundim që OE “ Company Zuka Commerce Sh.p.k. ” i mungojnë Makineritë e caktuara dhe është cekuar që sipas Pretendimit të OE me përfaqësues Ztr. Musë Pireva arsyet e eliminimit nuk qëndrojnë .

Rrjedhimisht, në asnjë mënyrë Zyrtarët e Prokurimit nuk kanë konfirmuar në atë se çfarë është pretenduar nga ana juaj.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi


U.D Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.